



Pranuar / Dorezuar Prilježen/Prudato Received/Delivuty	11.10.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Hr Prof Br Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	6094/2022		1/0



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.185/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj Demi -anëtarë, si dhe Zyla Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1516/19 të datës 01.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/532/2014 të datës 04.11.2014, të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Ferizaj, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A/02/532/2014 e datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunë të Leposaviqit sipas Akt emërimit të datës 01.09.2013 në vendin e punës "Staf i administratës", me datën 10.12.2013, ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 1 01 118-156 tek Komuna e Leposaviqit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Në bazë të Vendimit të datës 31.07.2014 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit ankuesja largohet nga lista e pagave nga muaji gusht i vitit 2014 me arsyetimin se ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesja e pa kënaqur me largimin nga lista e pagave, me datën 09.09.2014 parashtron kërkesën për sqarim te Kryetari i Komunës së Leposaviqit lidhur me largimin nga lista e pagave për muajin gusht te vitit 2014.

Kryetari i Komunës se Leposaviqit, me datën 25.09.2014 i është përgjigjur ankueses ne kërkesës e datës 09.09.2014, duke e njoftuar ankuesen se „paga për muajin gushtë të vitit 2014 nuk është paguar me arsyetimin se e njëjta në muajin dhjetor te vitit 2013 e ka realizuar të drejtën për pensionim dhe mbi bazën e kësaj edhe është nxjerrë vendimi për përfundimin e marrëdhënies se punës ne administratën komunale, kështu që nuk kemi obligim për të bërë pagesën e të njëjtës”.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin për largim nga lista e pagave, me datë 30.09.2014 përmes postës së Kosovës parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Leposaviqit dhe tek Kryetari i Komunës se Leposaviqit me pretendimin ankimor kundër largimit të saj nga lista e pagave.

Ankuesja kundër heshtjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunë të Leposavit, me datë 04.11.2014, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokoli 3300/2014.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 13.11.2014 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna Leposaviq. Me datë 01.12.2014 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Leposaviqit, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Lidhur me ankesën e ankueses me datës me date 18.12.2014 dhe 30.01.2015 Këshilli ka kërkuar informata shtesë nga MAP.

Kryetari i Këshilli me datë 31.12.2014 ka nxjerrë Vendimin me numër të protokollit 4283/2014 për zgjatje të afatit të ankesës edhe për një muaj me qëllim te grumbullimit te provave shtese lidhur me ankesat e ankuesve.

Lidhur me pretendimet e ankueses me datë 31.12.2014 dhe 02.02.2015, Këshilli ka pranuar përgjigje nga MAP me shkresat e bashkangjitura

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.02.2015 ka nxjerr Vendim me numër A/02/532/2014 me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër A/02/532/2014 të datë 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me datë 06.02.2019 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.430/15-c, i cili në Këshill është pranuar me date 08.03.2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses Mejrema Bahtijareviç, duke e anuluar Vendimin me numër A/02/532/2014 të datës 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit nuk ka mundur të rishqyrtoj ankesën me numër A.02/532/2014 të datës 04.11.2014, kështu që me datën 15.05.2019 ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 01.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1516/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për kërkesën e ankueses të datës 08.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke e rishqyrtuar ankesën e ankuesit, ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër Anr.1516/2019 Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, me datë 01.05.2021, e pranuar me datë 13.09.2022 me numër protokolli 5357/2022; Kërkesën e datës 08.05.2019 të përfaqësuesit të ankuesve në Këshill; Aktgjykimin me numër A.nr.430/15-c të datës 06.02.2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokolli 3300/2014 të datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin me Nr. 145A/13 i datës 01.09.2013 e ankueses; Aktgjykimin me numër Anr.1516/2019 Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, me datë 01.05.2021, e pranuar me datë 13.09.2019 me numër protokolli 5357/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 3300/2014 të datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin me Nr. 145A/13 i datës 01.09.2013 i ankueses; Lista e pagave e datës 31.03.2014, e datës 30.04.2014, e datës 31.05.2014, e datës 30.06.2014, e datës 31.07.2014, Shkresë nga zyra e Auditorit të Përgjithshëm; Dëftesë e datës 10.09.2014; Kërkesë e datës 09.09.2014 për Kryetarin e Komunës së Leposaviqit, për mes postës PTT të datës 01.10.2014; Përgjigje e datës 25.09.2014 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit, për ankuesen; Dëftesë e datës 01.10.2014; Kërkesë e datës 30.09.2014 për Kryetarin e Komunës së Leposaviqit, nga ankuesja; Autorizim i datës 03.10.2014; Përgjigje në Kërkesën 4095/2014 të datës 31.12.2014; Vendimi i datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; formular i datës 01.08.2014 me rastin e pensionimit; Vendimin me numër 118-156 i datës 20.12.2013 me rastin e pensionimit; Kërkesë për informatë shtesë e datës 21.04.2015 nga KPMSHCK-së për mes E-mail i datës 02.02.2015; Email i datës 30.01.2015 nga DASHC/MAP; Kërkesë për informatë shtesë e datës 19.12.2014 nga KPMSHCK-së; Akt emërimi i datës 01.09.2013; Përgjigje e datës 01.12.2014; Kërkesë e datës 10.12.2013; Njoftimi i datës 26.08.2019; Kërkesë për shqyrtim të ankesës nga Gjykata e datës 08.05.2019 nr. protokolli 2224/2019; Autorizim i datës 02.03.2015; Aktgjykim Anr.430/15-c i datës 06.02.2019 Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, i pranuar në KPMSHCK me datën 08.03.2019 me procesverbal; Përgjigje në padi e datës 12.11.2018/06.07.2018; ; Përgjigje në padi e datës 12.11.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe duke bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15-c të datës 06.02.2019 dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1516/19 të datës 01.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe të pranuar në këshill më datë 13/09/2022 me nr.pro.5357/2022, si dhe pas administrimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses, është e pa bazuar, *sepse*:

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se ankuesja posedon Akt Emërim me Nr.145A/13 të datës 01.09.2013, sipas së cilës e njëjta ka mbajtur pozitën e punës "*Punëtore administrative*", në Komunën e Leposaviqit, si nëpunëse e karrierës pa afat dhe se gjatë periudhës Mars-Korrik 2014 ka qenë në listën e pagave të Punëtorëve të Komunës së Leposaviqit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, e cila pretendon se Kryetari i Komunës së Leposaviqit, në mënyrë të paligjshme i ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe e ka pezulluar nga të ardhurat personale, duke shtuar me tej se ankuesja posedon kontratë të rregullt pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe bazuar në vërejtjet sipas aktgjykimit A.nr.430/15-c të datës 06.02.2019 vëren se ankuesja kishte mbajtur pozitën "*Punëtore administrative*", në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Leposaviqit, sipas Akt Emërimit me numër 145A/13 të datës 01.09.2013.

Po nga shtjellimi i shkresave të lëndës Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil (me tej DASHC) pranë Ministrisë së Administratës Publike, përmes shkresës së datës 30.01.2015, ka konfirmuar se DASHC-ja nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga Komuna e Leposaviqit dhe nuk ka miratuar ndonjë kërkesë për shpallje të konkursit lidhur me pozitën e ankueses.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: "*Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore*", ndërsa neni 19 i po të njëjtit ligj ka paraparë se: "*Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike,...*", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pranimi në Shërbimin Civil bëhet vetëm përmes procedurës së caktuar të rekrutimit. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh se emërimi i ankueses në pozitën e "*Punëtore administrative*" në Komunën e Leposaviqit, është bërë pa ndonjë procedurë pranimi, nga se nuk na është ofruar asnjë dëshmi nga asnjëra palë në procedurë se e njëjta në mënyrë të ligjshme e ka fituar këtë pozitë të nëpunëses civile, në këtë kuptim Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Po ashtu kolegji analizoi përmbajtjen e ankesës sa i përket kthimit të ankueses në punë dhe konstatoi se me qenë se e njëjta tashmë është mbi moshën 65 vjeçare, e lindur më datë 02/10/1952, në kuptim të dispozitave të legjislacionit të Shërbimit Civil aktual e njëjta nuk mund ta ketë statusin e nëpunësit civil dhe mbi këtë bazë nuk u lëshua në shqyrtim të mëtutjeshëm të këtij pretendimi ankimor.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në vërejtjet sipas Aktgjykimin me numër A.nr.430/15-c të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.185/2019**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqsesit të autorizuar Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;
- Menaxherit të Komunës së Leposaviqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.